

Gjatë periudhës raportuese, ZKA ka intensifikuar bashkëpunimin me palët e interesit në vend dhe jashtë vendit duke rritur bashkëpunimin me sektorin e drejtësisë dhe është rritur ndjeshëm komunikimi me organizatat e shoqërisë civile. Pjesëmarrja dhe kontributi i ZKA-së në aktivitetet rajonale dhe ndërkombëtare në fushën e auditimit ka qenë i suksesshëm dhe është vlerësuar lartë.

Një kapitull i veçantë i punës sonë lidhet me raportimet në Komisionet Parlamentare të Kuvendit të Kosovës. Në vazhdimësi kemi bërë përpjekjet tona t'u përgjigjemi të gjitha kërkesave të deputetëve dhe trupave të Kuvendit duke ofruar ekspertizën dhe produktet tona.

Vlerësimet e punës sonë në Raportin e Progresit për Kosovën (2018), të Bashkimit Evropian, Raportin e Monitorimit për Administratën Publike (2017), të publikuar nga SIGMA, Raportin Barometri i Ballkanit (2017), të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal kanë nxjerrë ZKA-në jo vetëm si njërin ndër institucionet më kredibile në vend, por edhe në Ballkanin Perëndimor.


Dëshiroj me këtë rast të falënderoj të gjitha palët që kanë ndihmuar në realizimin e objektivave tona.

Më lejoni po ashtu të shpreh respektin për personelin e Zyrës dhe për subjektet e audituara që kanë punuar së bashku për përmbushjen e objektivave audituese, në interes të përmirësimit të qeverisjes në institucionet publike në Kosovë.

Fokusi jonë në aktivitetet e ardhshme do të jetë i orientuar në vazhdimësi në rritjen e mëtejshme të cilësisë së auditimeve dhe rritjen e kapaciteteve institucionale të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Besoj që ky raport do të jap një informacion të bollshëm për punën tonë gjatë vitit 2017, derisa ne mbesim në dispozicion të Kuvendit për të shpalosur në detaje rezultatet tona.

Prishtinë, 30 prill 2018



Besnik Osmani

Auditor i Përgjithshëm

Misioni dhe Vizioni i ZKA-së

ZKA është institucion i pavarur në shërbim të qeverisjes së mirë dhe publikut. ZKA-ja është e përkushtuar në përmbushjen e mandatit të saj kushtetues e ligjor me një vizion të qartë drejt së ardhmes.

Vizioni

Institucion i besueshëm i auditimit që përmirëson qeverisjen në sektorin publik në interes të qytetarëve.

Misioni

Përmes auditimeve cilësore fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Vlerat

“Vlerat e Zyrës Kombëtare të Auditimit janë: pavarësia, profesionalizmi, integriteti dhe transparencën”

Veprimtaria e ZKA-së:

- kryen auditime për të siguruar se qeveria dhe entitetet e sektorit publik janë përgjegjëse për përdorimin dhe administrimin e fondeve publike;
- forcon përgjegjshmërinë, transparencën dhe integritetin duke audituar në mënyrë të pavarur aktivitetet e sektorit publik dhe duke raportuar gjetjet e tyre;
- iu ndihmon zyrtarëve të ngarkuar me qeverisjen e sektorit publik, të përmbushin përgjegjësitë e tyre përmes gjetjeve të auditimit, rekomandimeve dhe duke marrë masa korrigjuese të përshtatshme; dhe
- raporton mbi rezultatet e auditimit, duke i dhënë në këtë mënyrë mundësinë publikut të shikoj dhe të monitoroj përgjegjshmërinë e qeverisë dhe të entiteteve të sektorit publik.

Përmbledhje ekzekutive

Raporti i performancës së aktiviteteve të ZKA-së, për vitin 2017, për të demonstruar nivelin e performancës së ZKA-së kundrejt standardeve të INTOSAI-it bazohet në strukturën e Kornizës së Matjes së Performancës së ISA-ve. Kjo kornizë ka një grup treguesish për të matur performancën e ISA-ve kundrejt praktikave më të mira ndërkombëtare në drejtim të menaxhimit institucional ashtu edhe të performancës së veprimtarisë audituese. ZKA bazuar në këtë metodologji ka kryer vlerësimin e gjashtë fushave si në vijim:

Fusha e parë e Kornizës së Matjes së Performancës së ISA-ve është **“Pavarësia dhe Korniza Ligjore”**.

Ligji për “Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit” i miratuar në vitin 2016 ka forcuar pavarësinë funksionale, financiare dhe operative si parakusht për përmbushjen e mandatit kushtetues e ligjor të Auditorit të Përgjithshëm dhe ZKA-së. Ligji i jep një mandat të gjerë të auditimit të të gjitha aktiviteteve financiare, administrative dhe të tjera, programe dhe projekte, përfshirë edhe proceset.

Për të zbatuar në praktikë Ligjin për ZKA-në, u hartuan aktet nën ligjore si: Rregullore për Marrëdhënie Pune, Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ZKA, Udhëzimin Administrativ për Zbatimin e të Drejtave dhe Përgjegjësive të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Entiteteve të Audituar, Rregullorja për Administrimin e Dokumenteve etj.

Indikatorët matës për fushën **“Qeverisja e mirë dhe Etika”**, tregojnë se për përmbushjen e vizionit të ZKA-së, ZKA ka në zbatim “Planin Zhvillimor Korporativ 2015-2020”, që përcakton orientimin strategjik të institucionit me synimin që të arrihet qëndrueshmëria institucionale, të ruhet dhe ngritet më tej cilësia e qeverisjes korporative dhe cilësia e auditimit dhe në këtë mënyrë të kontribuohet në përmirësimin e qeverisjes në vend. Ky dokument strategjik është në proces të rishikimit.

ZKA ka bërë përshtatje të strukturës organizative me qëllim të shfrytëzimit sa më efikas të gjitha burimeve të saj, për arritjen e objektivave strategjike të organizatës.

Bazuar në faktin se Kodi i Etikës është një deklaratë e vlerave dhe parimeve të cilat e udhëheqin punën audituese për të siguruar besim tek institucioni, ZKA gjatë vitit 2017 ka hartuar një Kod të ri të Etikës dhe Mirësjelljes nën frymën e parimeve që përmban Kodi i Etikës i INTOSAI-t.

ZKA-ja vepron mbi themelet e transparencës dhe të llogaridhënies. Për këtë arsye ka ndërtuar një komunikim efektiv si në drejtim vertikal ashtu edhe në atë horizontal. Sa i përket kontrolleve të brendshme, ZKA, ka të ndërtuar një sistem të tillë që aktivitetet e saj i kryen nëpërmjet rregullave dhe procedurave të vendosura për procese të ndryshme.

Indikatorët matës për fushën **“Mbulimi i auditimeve dhe raportimi”** janë rezultatet e auditimit të rregullsisë, të performancës dhe ndikimi i tyre që i shtojnë vlerë menaxhimit financiar të institucioneve publike. Përgjithësisht indikatorit ka të bëjë me numrin e auditimeve (mbulimi i

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

auditimeve dhe raportimi), pra me veprimtarinë audituese dhe reagimin e subjekteve të audituara ndaj rekomandimeve të dhëna nga ZKA.

Gjysmën e parë të vitit 2017 e karakterizon një punë intensive e përfundimit të auditimeve të rregullsisë për vitin 2016. Kemi publikuar 92 raporte të auditimit të rregullsisë, katër raporte të ndërmarrjeve publike, 10 raporte të auditimit të performancës dhe dy raporte auditimi të projekteve të financuara nga donatorët. Detajet për këto raporte janë të prezantuar më poshtë në këtë Raport.

Një nga treguesit kryesor të matjes së ndikimit të auditimit është shkalla e zbatimit të rekomandimeve. Me qëllim të rritjes së shkallës së zbatimit të rekomandimeve, me Raportin Vjetor të Auditimit 2016, Auditori i Përgjithshëm i ka rekomanduar Kuvendit që të kërkojë nga Qeveria një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe të raportojë për progresin e arritur në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Mbi bazën e pavarësisë funksionale, në fillim të çdo sezoni të auditimit, ZKA-ja harton planin vjetor të auditimit. Për sezonën audituese 2017/2018, numri i auditimeve është në rritje në krahasim me vitin paraprak. Janë planifikuar 101 auditime të rregullsisë, përfshirë në këtë numër janë edhe nëntë auditime të pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike.

Meqë, auditimet e performancës promovojnë qeverisjen e mirë, ZKA-ja e ka mbajtur vëmendjen tek shtimi i numrit dhe rritja e cilësisë së auditimeve të performancës. Kryerja e auditimeve të performancës është në linjë me objektivat e ZKA-së, kështu që për sezonën audituese 2017/2018, janë planifikuar 20 auditime të performancës të fushave të ndryshme si arsimi, shëndetësia, mjedisi, zhvillimi ekonomik, dhe sistemet e teknologjisë së informacionit.

Sipas indikatorit matës **“Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse”**, ZKA-ja i menaxhon operacionet e veta me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Pasqyrat financiare të ZKA-së publikohen dhe janë subjekt i auditimit të jashtëm të pavarur. ZKA publikon buxhetin mbi burimet financiare dhe raporton për përdorimin e këtyre burimeve.

“Burimet njerëzore dhe trajnimet”. Qëllimi i ZKA-së është që të përmirësojë në vazhdimësi performancën e vet, e kjo mund të arrihet duke investuar në zhvillimin profesional të burimeve njerëzore. Trajnimi i vazhdueshëm profesional brenda dhe jashtë vendit është parë si një mënyrë për të kontribuar në cilësi më të mirë dhe qasje efektive për ngritjen e kapaciteteve.

“Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit” është një nga objektivat strategjike të ZKA-së që ata ta kuptojnë punën audituese dhe rezultatet e saj. Ky komunikim gjatë vitit është intensifikuar me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin. Meqë, shoqëria është gjithnjë e më e vetëdijshme për mbajtjen e qeverive të përgjegjshme, ZKA ka për qëllim që të arrijë direkt tek qytetarët dhe shoqëria civile duke vendosur një komunikim të rregullt, me qëllim krijimin e një forumi konsultativ për të koordinuar bashkëpunimin dhe fuqizuar më shumë transparencën dhe llogaridhënien. Bashkëpunimi me palët e interesit bëhet përmes Rrjetit të ISA-ve, Komitetit të Kontaktit, INTOSAI dhe EUROSAI. Synimi i ZKA-së është anëtarësimi me të drejta të barabarta në këto organizata dhe grupe.

Fokusi jonë në aktivitetet e ardhshme do të jetë i orientuar në:

- Rritjen e cilësisë së auditimeve, në përputhje me SNISA-të
- Rritjen e portofolios së auditimeve të performancës, përfshirë auditimet e TI-së
- Ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të brendshme institucionale
- Thellimin e bashkëpunimit me Kuvendin, përkatësisht komisionet parlamentare
- Komunikimin efektiv dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe mediat
- Intensifikimin e bashkëpunimit bilateral me ISA-të tjera, dhe
- Angazhimin për anëtarësimin në organizatat rajonale e ndërkombëtare të ISA-ve

1 Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra Kombëtare e Auditimit

Hyrje

Auditori i Përgjithshëm është një institucion kushtetues i pavarur dhe i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. ZKA ndihmon Auditorin e Përgjithshëm, mandati dhe detyrat e të cilit janë përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligjin nr. 05/L-055 “Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës”.

Ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë së ZKA-së nga organizatat të cilat i auditon është vendimtare. Objektiviteti dhe pavarësia duhet të sigurohen me anë të zbatimit të mirë të një mandati të gjerë, të qëndrueshëm dhe ligjor, pajtueshmërisë me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht, dhe një kodi të brendshëm për mirësjellje profesionale.

Aktiviteti i Zyrës Kombëtare të Auditimit

ZKA kryen auditime të rregullsisë të Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave buxhetore në bazë vjetore, ku përfshihen Kuvendi, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Ministrinë dhe Agjencitë ekzekutive, Komunitat, Institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet publike.

ZKA kryen auditime të performancës, të projekteve të financuara nga fondet donatorëve dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, si dhe auditime të sistemeve të TI. Këto auditime kryhen në mënyrë që të vlerësojmë nëse programet qeveritare janë duke u menaxhuar si duhet, ekonomikisht dhe në mënyrë efikase, dhe nëse janë vendosur masa për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre.

ZKA raporton për auditimet e saj tek Kuvendi, përkatësisht Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP). Raportet individuale të auditimit u dërgohen entiteteve të audituara dhe publikohen në ueb faqen e ZKA-së. Raportet e auditimit përmbajnë rekomandime me qëllim të nxitjes së ndryshimit dhe zbatimit të praktikave më të mira. Në këtë mënyrë, Kuvendit, institucioneve të audituara, taksapaguesve dhe publikut në përgjithësi i ofrojmë informacione për menaxhimin e financave publike dhe për pajtueshmërinë e vendimeve të tyre administrative.

Me qëllim që të ndihmojmë në zbatimin, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e Menaxhimit të Financave Publike, ne do t'i sigurojmë tatimpaguesit dhe donatorët ndërkombëtar se burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive dhe efikase. Këtë do ta bëjmë duke siguruar se fondet publike raportohen, administrohen dhe përdoren në mënyrën e duhur dhe me maturi.

Procesi i llogaridhënies

Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) përgatiten sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Ato duhet të jenë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik mbi bazën e parasë së gatshme. Për të na mundësuar të dëshmojmë përgjegjshmërinë dhe objektivitetin tonë, Kuvendi çdo vit do të angazhoj një firmë të jashtme të pavarur dhe të pranuar ndërkombëtarisht që të kryejë auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të ZKA-së. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së.

Përveç auditimeve të jashtme, edhe auditimet e brendshme të kryera nga Njësia për Auditim të Brendshëm sigurojnë Auditorin e Përgjithshëm që ZKA-ja vepron në pajtueshmëri me ligjet, aktet e brendshme nënligjore dhe politikat e veta.

Kush do të rishikojë financimin e ZKA-së?

ZKA përgatit dhe dorëzon çdo vit në Kuvend kërkesat buxhetore. KMFP dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa (KBF) mund të kërkojnë sqarimet e nevojshme për kërkesën buxhetore të ZKA-së dhe për të diskutuar mbi planet, prioritetet, objektivat e performancës, raportimin vjetor të performancës, dhe praktikat tona të menaxhimit.

Vëzhgimet mbi Performancën e ZKA-së dhe Ndikimin e saj

ZKA, nëpërmjet auditimeve ka për synim të kontribuojë dhe të ndikojë drejtpërdrejtë në ndryshimin e jetës së qytetarëve të bazuar edhe në SNISA 12 “Vlerat dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit – Për një ndryshim në jetën e qytetarëve”.

Vlerësime për performancë të ZKA-së dhe për ndikimin e saj kanë dhënë edhe institucione ndërkombëtare si: Raporti “Barometri i Ballkanit për vitin 2017”, i publikuar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (RCC), të cilit i referohet edhe SIGMA në raportin e saj për vitin 2017. Sipas këtij raporti, anketat e bëra me qytetarët në Kosovë tregojnë që ata kanë besim që ZKA mund të ketë ndikim pozitiv në menaxhimin financiar në Kosovë. Mbi 48% e respondentëve i besojnë ZKA-së, ndërsa 67% e tyre pajtohen që ZKA mund të ndikoj që ta bëjë qeverinë më të përgjegjshme në shpenzimin e parasë publike. Këto norma janë të larta në krahasim me vendet tjera në rajon.

2 Performanca e Zyrës Kombëtare të Auditimit

Korniza e Matjes së Performancës së ISA-ve, si dokument standard i INTOSA-it, ka 25 tregues për të matur performancën e ISA-ve kundrejt praktikave më të mira ndërkombëtare në drejtim të menaxhimit të institucionit ashtu edhe të performancës së veprimtarisë audituese të grupuara në gjashtë fusha:

- Pavarësia dhe Korniza ligjore;
- Qeverisja e Brendshme dhe Etika;
- Cilësia e Auditimit dhe Raportimi;
- Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet mbështetëse;
- Burimet njerëzore dhe Trajnimet; dhe
- Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit.

Raporti i Performancës së ZKA-së, për vitin 2017, është kryer bazuar në këtë dokument standard dhe ka përcaktuar 16 tregues kryesor performance të fushave të sipërpërmendura. Matja e tillë e performancës mundëson që të identifikojmë pikat e forta dhe të dobëta të punës audituese si dhe të menaxhimit të organizatës.

Matja e punës nëpërmjet këtyre treguesve jep një pasqyrë të aktiviteteve dhe rezultateve të fushave të një ISA. Matjet e performancës në bazë të këtyre treguesve, e bëjnë të mundur krahasimin e performancës së aktiviteteve të një ISA me institucionet tjera simotra.

2.1 Pavarësia dhe Korniza ligjore

Kjo fushë mbulon mandatin ligjor të ZKA-së dhe pavarësinë e saj. SNISA 1 (Deklarata e Limës) dhe SNISA 10 (Deklarata e Meksikës mbi Pavarësia e ISA-ve) është baza e praktikave të mira për këtë fushë. Indikatorët matës që ZKA-ja ka aplikuar për këtë fushë janë: pavarësia dhe mandati i ZKA-së.

Pavarësia e Auditorit të Përgjithshëm dhe e Zyrës Kombëtare të Auditimit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm e që është bazë për organizimin, funksionimin dhe mandatin e tij në kryerjen e auditimeve.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 05/L-055 “Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit” nga qershori i vitit 2016, është konsoliduar pavarësia funksionale, financiare dhe operative. Auditori i Përgjithshëm dhe ZKA-ja ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave për të zbatuar mandatin e tij në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit në sektorin publik. Sipas legjislacionit në fuqi, Auditori i Përgjithshëm është i pavarur në organizimin dhe menaxhimin e ZKA-së.

Auditori i Përgjithshëm për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligj, është llogaridhënës para Kuvendit të Kosovës.

Progresi pas miratimit të Ligjit nr. 05/L-055 “Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës”

Me hyrjen në fuqi të Ligjit, Auditori i Përgjithshëm me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore, filloi me hartimin e rregulloreve të brendshme për të përcaktuar organizimin dhe menaxhimin e brendshëm të ZKA-së. Gjatë periudhës raportuese janë hartuar dhe aprovuar: Rregullorja për Marrëdhënie Pune, Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ZKA, Udhëzimin Administrativ për Zbatimin e të Drejtave dhe Përgjegjësi të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Entiteteve të Audituar, Rregullorja për Administrimin e Dokumenteve etj.

Mandati i Zyrës Kombëtare të Auditimit

Ky tregues vlerëson autoritetin operacional të ZKA-së të përcaktuar në kornizën ligjore. Në cilësinë e institucionit suprem të auditimit të burimeve financiare qeveritare, ISA-i duhet të ketë autoritet të mjaftueshëm sipas kornizës ligjore, në të cilën përcaktohet roli i tij dhe përshkruhen qartësisht operacionet e Financave Publike për të cilat ai ka përgjegjësinë ligjore t’i auditojë.

Dimensionet për të vlerësuar këtë tregues janë:

i) Mandati i mjaftueshëm dhe i gjerë

Ligji “Për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës”, AP i jep një mandat të gjerë të auditimit të të gjitha aktiviteteve financiare, administrative, programeve dhe projekteve, përfshirë proceset e të ardhurave nga shitja e pasurive, privatizimit dhe koncensionet. ZKA mund të kryejë auditime të rregullsisë edhe në Ndërmarrjet Publike. Po ashtu, kryen edhe auditime të performancës për të vlerësuar efikasitetin, efektivitetin dhe ekonomikitetin e një aspekti të veçantë të operacioneve në tërësi ose të pjeshme të ndonjë institucioni, programi ose aktiviteti.

ii) Qasja në informacione

Auditori i Përgjithshëm ka qasje të pakufizuar në të gjitha informatat dhe shpjegimet, që vlerëson se i nevojiten për qëllime të auditimit. Zyrtarët e autorizuar nga AP mundën në çdo kohë të arsyeshme të hyjnë dhe të qëndrojnë në objektet e entitetit ose institucionit i cili është i caktuar që të auditohet.

iii) E drejta dhe detyrimi për të raportuar

Auditori i Përgjithshëm e ka autoritetin e kërkuar nga Kushtetuta që në mënyrë të pavarur të raportoj gjetjet e çdo viti në Kuvend, të cilit i paraqet:

- Raportin për zbatimin e Buxhetit të Shtetit;
- Mendimin për raportin e Qeverisë për shpenzimet e vitit financiar të shkuar, para se të miratohet nga Kuvendi;
- Raportin vjetor për veprimtarinë e ZKA-së.

ZKA, të gjitha raportet e veta vjetore të auditimit duhet t’i bëj publike.

2.2 Qeverisja e brendshme dhe etika

Kjo fushë mbulon qeverisjen e brendshme dhe etikën e ZKA-së. Indikatorët matës që ZKA ka aplikuar janë: planifikimi strategjik, mjedisi i kontrollit organizativ, komunikimi i brendshëm dhe planifikimi i auditimeve.

Objektivë e ISA-ve duhet të jetë promovimi i transparencës dhe llogaridhënies përmes mirëqeverisjes dhe etikës për të përmbushur mandatin e tyre.

2.2.1 Planifikimi strategjik & operativ

Planifikimi strategjik - Që një organizatë të jetë e suksesshme është e nevojshme që të përcaktohen objektivat më të rëndësishme të saj në kuadër të një plani strategjik. Për përmbushjen e vizionit të saj, ZKA-ja ka në zbatim "Planin e Zhvillimit Korporativ 2015-2020". Ky dokument përmban tri shtylla të cilat adresojnë sigurimin e pronësisë vendore dhe qëndrueshmërinë institucionale, kontributin në forcimin e qeverisjes së mirë, ruajtjen dhe ngritjen e cilësisë së qeverisjes korporative dhe të auditimit.

Me miratimin e Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe me ardhjen e Auditorit të ri ka ndryshuar qasja strategjike dhe për këtë arsye Auditori i Përgjithshëm, në vitin 2017, ka themeluar një grup punues i cili është në proces të hartimit të strategjisë së re 2018-2020.

Dokumentet strategjike të ZKA-së janë publike dhe të qasshme si për personelin e ZKA-së ashtu edhe për publikun e gjerë.

Plani Vjetor i Punës - Me qëllim të menaxhimit të aktiviteteve të përditshme, për sezonën audituese 2017/2018, ZKA hartoi Planin Vjetor të Punës, plan i cili përmban objektivat e ZKA-së, llojet e auditimeve, procesin e auditimit, planin vjetor të auditimit dhe organizimin, buxheti dhe burimet njerëzore, bashkëpunimi dhe projektet.

2.2.2 Mjedisi i kontrollit organizativ

ISA duhet të ketë një sistem të kontrollit të brendshëm që ofron siguri të arsyeshme se operacionet e saj i menaxhon në mënyrë efikase dhe ekonomike në përputhje me ligjet dhe rregulloret sipas Standardit të Qeverisjes 9100 të INTOSAI-t. Përveç kësaj, ISA duhet të ketë edhe një sistem të kontrollit të cilësisë që e siguron cilësinë e gjithë punës së saj (SNISA 40).

Në funksion të këtyre janë ndërmarrë disa hapa konkret:

Ndryshimet e strukturës organizative

Për të përmbushur pritjet nga ZKA-ja, Auditori i Përgjithshëm ka bërë një përshtatje të re të strukturës organizative me qëllim të arritjes së objektivave strategjike të organizatës.

Për të forcuar kontrollin e cilësisë në auditim, në linjë me standardin ISSAI 40 "Kontrolli dhe Sigurimi i Cilësisë", me strukturën e re organizative u krijua Divizioni për Menaxhimin e Cilësisë në Auditim si divizion i veçantë. Po ashtu, në funksion të arritjes së objektivave të ZKA-së, u

krijuan edhe dy departamente të reja: Departamenti për auditimin e ndërmarrjeve publike dhe Departamenti për auditimin e prokurimit dhe projekteve. Ndërsa si pjesë e departamentit të performancës ka hyrë edhe auditimi i sistemeve të TI.

Rregullorja e re për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, përmban rregullat për organizimin dhe funksionimin e ZKA-së.

Hartimi i Kodit të Etikës së ZKA-së

Bazuar në faktin se Kodi i Etikës është një deklaratë e plotë e vlerave dhe parimeve të cilat e udhëheqin punën e përditshme të audituesve për të siguruar besim tek Institucioni, ZKA-ja në vitin 2017 ka hartuar një Kod të ri të Etikës dhe Mirësjelljes nën frymën e parimeve që përmban Kodi i Etikës i INTOSAI-t.

Kodi i ri i Etikës dhe Mirësjelljes riafirmon vlerat dhe pasqyron parimet thelbësore në të cilat bazohet veprimtaria jonë. Këto vlera dhe parime përmbajnë nga njëra anë shtyllat e besueshmërisë institucionale dhe nga ana tjetër, janë të lidhura ngushtë me të kuptuarit e ZKA-së si një institucion kushtetues në shërbim të llogaridhënies, qeverisjes së mirë dhe transparencës.

Në funksion të arritjes së sigurisë së mjaftueshme, ZKA-ja ka krijuar politika dhe procedura, të cilat kërkojnë që gjithë personeli dhe palët e autorizuara për të kryer punë për ZKA-në, të pajtohen me kërkesat etike më të rëndësishme duke nënshkruar Kodin e etikës dhe Deklaratën e pavarësisë profesionale.

Po ashtu, është themeluar edhe Komisioni për Etikë për të përcjellë zbatueshmërinë e Kodit të Etikës.

Sistemi i kontrollit të brendshëm

Sistemet e kontrollit të brendshëm janë të rëndësishme për të gjitha operacionet e ZKA-së. Kontrollat e brendshme për aktivitetet jo audituese, ZKA, i kryen nëpërmjet rregullave dhe procedurave të vendosura për procese të ndryshme si: ndarja e detyrave, delegimi, autorizimi, mbikëqyrja dhe auditimi i brendshëm.

Në ZKA, vepron një auditor i brendshëm që përgatit raporte mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm në fusha të ndryshme dhe i raporton drejtpërdrejtë Auditorit të Përgjithshëm. Bazuar në planin vjetor për vitin 2017, fushat e përcaktuara për rishikim nga Njësia e Auditimit të Brendshëm kanë qenë: menaxhimi i pasurisë, procesi i buxhetimit dhe shpenzimeve, menaxhimi i procesit të rekrutimit, sistemi i menaxhimit të cilësisë si dhe aktivitete të prokurimit. Rishikimi është bazuar në vlerësim të performancës dhe pajtueshmërisë me rregullat ligjore dhe rregullativën e brendshme që rregullojnë fushat përkatëse.

Në gjysmën e dytë të vitit 2017 është themeluar edhe Komiteti i Auditimit i cili ka filluar me aktivitetet e tij me qëllim të ngritjes së llogaridhënies dhe përmirësimit të qeverisjes, menaxhimit të rrezikut të kontrollit të brendshëm si dhe mbështetjes së AP-së në adresimin e përgjegjësiave lidhur me zbatimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Komunikimi i brendshëm

ZKA-ja ka ndërtuar një komunikim efektiv të brendshëm me punonjësit, duke i dhënë mundësi secilit punonjës të shprehet hapur si në drejtimin vertikal ashtu edhe në atë horizontal për çështjet që lidhen me punën e tyre si dhe për ato brenda institucionit.

Menaxhmenti i ZKA-së mban takime të rregullta periodike me gjithë personelin. Vendimet kryesore dokumentohen dhe i komunikohen stafit. Këto dokumente janë të qasshme për të gjitha nivelet organizative dhe ekziston një mekanizëm për shpërndarjen e informacionit tek stafi.

Po ashtu, ka një rrjetë të brendshëm të komunikimit elektronik përmes të cilit menaxhmenti i ZKA i informon rregullisht punonjësit mbi çështjet kryesore lidhur me organizatën.

Planifikimi i auditimit

Auditimet janë bërë sipas një plani të vet-përcaktuar nga ZKA. Bazuar në këtë, ZKA ka hartuar Planin Vjetor të Auditimit në fillim të sezonës audituese. Në hartimin e Planit është marrë në konsideratë përmbushjen e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë, mbulueshmëria sa më e gjerë me auditime të performancës bazuar në vlerësimin mbi rëndësinë dhe aktualitetin e çështjeve të caktuara dhe adresimi i kërkesave specifike të Kuvendit dhe të palëve të tjera të interesit, si donatorët, etj. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh edhe kapacitetet e burimeve njerëzore dhe financiare që ZKA ka pasur në dispozicion.

2.3 Mbulimi i auditimit dhe raportimi

Treguesit e kësaj fushe ndërlidhen kryesisht me fushëveprimin e auditimeve, mbulimit të auditimeve sipas llojit dhe në numër, adresimi i rekomandimeve nga organizatat buxhetore, raportimi i rezultateve të auditimeve dhe ndikimi i auditimeve të ZKA-së në menaxhimin e financave publike.

2.3.1 Fushë veprimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit

Në përputhje me fushëveprimin e saj ZKA kryen dy lloje të auditimeve:

- Auditime të rregullsisë të organizatave buxhetore (bazuar në sistemin e parasë së gatshme) dhe të ndërmarrjeve publike (bazuar në sistemin aktual); dhe
- Auditime të performancës, përfshirë auditimet e projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare, sipas kërkesës.

Auditimet e rregullsisë: përfshijnë auditimin e PFV-ve dhe llogarive kryesore të institucionit të audituar, me qëllim të vlerësimit nëse raportet janë të besueshme dhe llogaritë pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë; vlerësimin nëse menaxhmenti iu ka përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; dhe vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm. Këto auditime kryhen çdo vit dhe raportohen në një afat të caktuar kohor. Auditimet fillojnë në shtator, memot e auditimit

dorëzohen në dhjetor ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

ZKA-ja po ashtu kryen auditime të rregullsisë në Ndërmarrjet publike, të cilat e aplikojnë sistemin akrual të kontabilitetit.

Auditime të performancës: është një ekzaminim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit (minimizimi i kostove të burimeve), efikasitetit (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe efektiviteti (përbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara). Këto auditime përfshijnë tema të ndryshme në fushën e arsimit, shëndetësisë, prokurimit, infrastrukturës, social ekonomike, teknologjisë informative etj

Për kryerjen e auditimeve të performancës ZKA ndjek njërin nga tri qasjet:

- qasjen e orientuar në rezultate, e cila vlerëson nëse janë arritur objektivat e paracaktuara;
- qasjen e orientuar në problem, e cila verifikon dhe analizon shkaqet e problemit(ve); dhe
- qasjen e orientuar në sistem, e cila ekzaminon funksionimin e sistemeve menaxhuese: ose një kombinim të të tri qasjeve.

Auditime të prokurimit: janë auditime që vlerësojnë vlerën e arritur për para gjatë blerjeve përmes prokurimit. Kjo do të thotë se janë blerë mallra apo shërbime që kanë koston më të ulët apo optimale për tërë jetë gjatësinë (kjo nuk do të thotë çmimi më i ulët), që i shërbejnë qëllimit për të cilin janë blerë dhe i përbushin specifikat e nevojshme. Kur mallrat apo shërbimet e blera nuk kanë koston më të ulët, atëherë vlera e shtuar duhet të jetë e qartë dhe e arsyetuar. Auditimi i vlerës për para në prokurim po ashtu trajton ligjshmërinë dhe rregullsinë e këtyre proceseve.

Ky departament po ashtu kryen auditime të projekteve të një aspekti të veçantë të operacioneve në tërësi ose të pjesëme të ndonjë institucioni, programi apo aktiviteti, auditime të projekteve/fondeve të financuara nga Buxheti i Kosovës, buxheti i ndonjë shteti tjetër apo donatori për të vlerësuar shfrytëzimin e fondeve në pajtim me kushtet e përcaktuara.

Auditime të projekteve të financuara nga donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare kryhen në bazë të marrëveshjes me donatorët dhe/ose përfituesit e tyre. Për këto auditime ZKA aplikon një tarifë, ndërsa fondet e inkasuara derdhen në Buxhetin e Kosovës.

Përmes auditimeve dhe aktiviteteve tjera këshilluese, ZKA e mbështet llogaridhënien dhe transparencën e organizatave të audituara në përdorimin e parasë publike, pajtueshmërinë me kërkesat ligjore, qeverisjen e mirë, arritjen e vlerës për para si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.

2.3.2 Numri dhe lloji i raporteve të auditimit

Deri në fund të vitit 2017, ZKA ka përfunduar dhe publikuar:

- Raportin Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Kosovës (për vitin 2016);
- 92 raporte të auditimit të rregullsisë (për vitin 2016);
- 4 raporte të auditimit të ndërmarrjeve publike;
- 11 raporte të auditimit të performancës; dhe
- 2 raporte të auditimit të projekteve.

Për sezonën audituese 2017/18 janë planifikuar 124 raporte:

- Raporti Vjetor i Auditimit të Buxhetit të Kosovës për vitin 2017;
- 91 auditime të rregullsisë për organizatat qendrore dhe lokale;
- 9 auditime të rregullsisë për ndërmarrjet publike;
- 2 auditime të projekteve të financuara nga donatorët;
- 1 auditim për borxhet publike;
- 13 auditime të performancës; dhe
- 7 auditime të prokurimeve/projekteve.

Përmes auditimit të rregullsisë kemi arritur t'i mbulojmë të gjitha OB-të me përjashtim të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe Radio Televizionit të Kosovës.

Numri i auditimeve të rregullsisë dhe të performancës është duke u rritur, po ashtu planifikojmë që të rrisim numrin e auditimeve të projekteve të financuara nga donatorët si dhe huamarrjen në të ardhmen.

Tabela 1 tregon portofolin e përgjithshëm të auditimit, përfshirë numrin dhe llojet e auditimeve të paraqitura me një bazë krahasuese për dy vitet e fundit. Për më shumë detaje rreth raporteve të përfunduara dhe të auditimeve në proces, referojuni Shtojcës 2 të këtij Raporti.

Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të planifikuara dhe të kryera gjatë dy sezoneve të fundit të auditimit

Llojet e auditimit	Sezoni i auditimit	
	2017/2018	2016/2017
Auditime të rregullsisë	104	96
- Buxheti i Kosovës	1	1
- Institucione qendrore	24	24
- Institucione të pavarura	30	30
- Komuna	38	38
- Të kontraktuara	-1 ¹	-1 ²
- Ndërmarrje publike (sistemi akrual)	9	4
Auditimi i Borxheve publike	1	-
Projekte të financuara nga donatorët	2	-
Auditime të performancës dhe të projekteve	20	19
- Auditime të performancës	13	17
- Auditime të projekteve	7	2
Gjithsej	124	115

Nga tabela e më sipërme, shihet se për vitin 2017 janë në proces të auditimit të gjitha OB-të, përveç Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), auditimi i së cilës është kontraktuar nga ZKA dhe do të kryhet nga një firmë private e auditimit.

2.3.3 Standardet e auditimit të rregullsisë dhe kontrolli i cilësisë

Me qëllim të arritjes së objektivit për kryerjen e auditimeve në përputhje me SNISA të INTOSA-it, ZKA ka ndërmarrë disa hapa konkret në kompletimin e infrastrukturës së nevojshme rregullative dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale.

Azhurnimi i Doracakut të Auditimeve të rregullsisë

Në kuadër të zbatimit të SNISA-ve, në vazhdimësi bëhet azhurnimi i Doracakut të Auditimeve të Rregullsisë duke iu përshtatur kërkesave të ndryshimeve të bëra në SNISA. Qëllimi kryesor i këtij Doracakut është që t'i ofrojë secilit auditues një pikë referuese për ta ndihmuar gjatë gjithë procesit të auditimit të rregullsisë. Kjo nuk ka për qëllim të zëvendësojë ushtrimin e gjyqimit profesional i cili është parakusht për kryerjen e suksesshme të auditimit.

Për të siguruar cilësi të lartë të punës së auditimit të rregullsisë, Doracakut ofron një kornizë për planifikim, ekzekutim dhe raportim mbi auditimet, duke e theksuar rëndësinë e fokusimit në

¹ Për vitin 2016, ZKA ka kontraktuar një kompani private të auditimit për mbulimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL).

² Po ashtu në vitin 2017 është kontraktuar auditimi për MAPL-në.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

rrezik, për të kryer auditime efektive dhe efikase dhe për ta mbrojtur dhe ngritur reputacionin e ZKA-së.

Me fillimin e auditimeve të ndërmarrjeve publike është paraqitur nevoja të bëhet rishikimi i Doracakut të Auditimeve të rregullsisë. Nën mbështetjen e projektit të binjakëzimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Polonisë është filluar rishikimi i këtij Doracak. Plotësimet në Doracak do të bëhen për kërkesat specifike për ndërmarrjet publike. Në të njëjtën kohë, me përkrahjen e Zyrës Kombëtare të Suedisë, doracaku do të plotësohet edhe me pjesën e auditimeve të pajtueshmërisë.

Kontrolli i cilësisë

Sipas parimit bazë të SNISA 40 “Kontrolli i Cilësisë”, një ISA duhet të hartojë politika dhe procedura për të nxitur një kulturë të brendshme, e cila pranon se cilësia është thelbësore për të gjithë punën e saj.

Bazuar në këtë parim një ndër objektivat kryesore të ZKA-së ka qenë dhe mbetet kontrolli i cilësisë që ka për qëllim që të identifikojë mangësitë, përmirësimet që duhen ndërmarrë në të ardhmen, me qëllim të përmirësimit në vazhdimësi të punës në zbatimin e standardeve të auditimit.

Për sezonën e auditimit 2016/2017, rishikimi i cilësisë është bërë për:

- 79 dosje të auditimit për fazën e planifikimit;
- 50 dosje të auditimit për fazën e ekzekutimit;
- 30 memorandume të auditimit;
- 50 raporte të auditimit të rregullsisë; dhe
- 2 raporte të auditimit të performancës

Gjatë sezonit të auditimit 2017/2018, kanë përfunduar ose janë planifikuar për rishikim:

- 50 dosje të auditimit për fazën e planifikimit;
- 35 dosje të auditimit për fazën e ekzekutimit;
- 40 memorandume të auditimit; dhe
- 41 raporte të auditimit.

Sipas rezultateve nga dosjet e shqyrtuara, konstatohet se krahas rezultateve të arritura në ngritjen e cilësisë, është identifikuar nevoja për përmirësime të mëtejme, të cilat do të ndikojnë në arritjen e një niveli më të lartë të cilësisë për të gjitha fazat e auditimit. Prandaj, çdo vit bazuar në mësimet e nxjerra, janë bërë ndryshime pozitive në mënyrën se si janë kryer auditimet dhe se si janë raportuar rezultatet.

Në këtë mënyrë, cilësia e përgjithshme e punës dhe e produkteve tona është përafruar me kërkesat e SNA-së të ISA-ve dhe praktikat e mira evropiane, ndonëse ende ka për t’u bërë.

2.3.4 Ndikimi i auditimit në menaxhimin e financave publike

ZKA në auditimet e realizuara gjatë vitit 2016, përmes rekomandimeve ka kërkuar përmirësimin e menaxhimit të financave publike.

Numri dhe përqindja e rekomandimeve të zbatuara

Një nga treguesit kryesor të matjes së performancës së auditimit është shkalla e zbatimit të rekomandimeve. Bazuar në standardet e auditimit përcjellja e zbatimit të rekomandimeve është një nga aktivitetet e ZKA-së. Në raportet e auditimit të vitit 2016 kemi raportuar për gjendjen e rekomandimeve të dhëna një vit më parë. Rezultatet nga përcjellja dhe analizimi i progresit në zbatimin e rekomandimeve i kemi përmbledhur në tabelat e mëposhtme.

Tabela 2: Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2016 për vitin 2015

Subjektet e audituara	Rekomandimet e dhëna		Të zbatuara		Të adresuara (në proces)		Të pa adresuara	
	Nr		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet qendrore	338		93	28	126	37	119	35
Institucionet e pavarura	184		52	28	70	38	62	34
Komunat	640		153	24	229	36	258	40
Totali	1,162		298	26	425	36	439	38

Tabela 3: Zbatimi i rekomandimeve të dhëna në raportet e vitit 2015 për vitin 2014

Subjektet e audituara	Rekomandimet e dhëna		Të zbatuara		Të adresuara (në proces)		Të pa adresuara	
	Nr		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Institucionet qendrore	347		133	38	118	34	96	28
Institucionet e pavarura	200		94	47	57	29	49	24
Komunat	630		129	20	243	39	258	41
Totali	1,177		356	30	418	36	403	34

Zbatimi i rekomandimeve ka ngecje në krahasim me vitin paraprak.

Përveç rekomandimeve të lartpërmendura, kemi dhënë këshilla përmes memorandumeve të auditimit (gjatë fazës së ndërmjetme të auditimit) për përmirësimin e kontrolleve të brendshme dhe raportimin financiar. Si rezultat, PFV-të e OB-ve ishin të cilësisë më të mirë për dallim nga pasqyrat financiare nëntëmujore.

Po ashtu, në 10 auditime të performancës janë dhënë rekomandime të dobishme për përmirësimin e programeve dhe aktiviteteve në sektorin publik, në fushën e arsimit, investimeve publike, prokurimit, gjygjësorit etj.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Gjithashtu, kemi vlerësuar zbatimin e rekomandimeve të RVA-së të dhëna për Kuvendin e Kosovës, Qeverinë dhe për kuvendet komunale. Nga 39 rekomandime të dhëna, 6 janë zbatuar plotësisht, 21 janë në proces dhe 5 të tjera nuk janë adresuar ende (për më tepër referojuni Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2016, shtojca III).

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve që janë në proces dhe atyre të pa adresuara të dhëna në RVA për vitin 2016, Auditori i Përgjithshëm ka rekomanduar Kuvendin që të kërkojë nga Qeveria një raport në lidhje me rekomandimet e dhëna në RVA të vitit 2015, dhe të përgatisë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në RVA të vitit 2016 dhe raporte në lidhje me progresin e këtij plani në baza tremujore.

Si rezultat i këtyre rekomandimeve të AP-së, Kuvendi i Kosovës pasi që ka shqyrtuar rekomandimet e KMFP lidhur me Raportin Vjetor të Auditimit të ZKA-së për vitin 2016, në dhjetor të vitit 2017 ka miratuar rekomandimet që Qeveria të: përgatisë raport kthyes në lidhje me rekomandimet e AP-së për RVA për vitin 2015; përgatisë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve nga RVA për vitin 2016 si dhe të raportojë në KMFP në baza tremujore mbi progresin e arritur; që të gjitha OB-të të raportojnë mbi procesin sistematik të zbatimit të rekomandimeve në baza tremujore në Ministri të Financave dhe në KMFP.

2.3.5 Auditimi i performancës

Gjatë vitit 2017, janë publikuar 11 raporte të auditimit të performancës të fushave të ndryshme me interes ekonomik, shoqëror në aspektin e mbulimit të çështjeve me rëndësi që lidhen me shëndetësinë, arsimin, mjedisin, infrastrukturën, dhe sistemin e TI-së.

Trendi i auditimeve të performancës është në rritje prej vitit në vit. Me planin vjetor të auditimit për sezonin 2017/2018, janë planifikuar 20 auditime të performancës të cilat janë në proces që do të publikohen gjatë vitit 2018. Në kuadër të këtyre auditimeve, 13 janë auditime të performancës dhe sistemeve të TI-së dhe 7 auditime të prokurimeve dhe projekteve, si: Marrëveshjet për shërbime të veçanta; Fondi zhvillimor; Marrëveshjet e bashkëfinancimit; dhe Investimet kapitale në ndërmarrjet publike.

Në raportet e auditimit të performancës janë adresuar mesazhet kryesore të auditimit si në vijim:

Në Raportin **“Administrimi i programit për trajtim jashtë institucioneve shëndetësore publike”**, mesazhi i auditimit është se “Ministria e Shëndetësisë ende nuk ka siguruar një sistem/program ku do të regjistrohen të dhënat e plota për pacientët në nevojë. Priorizimi i aplikacioneve nga bordi nuk është bërë sipas llojit të sëmundjes me përjashtim të rasteve urgjente, po ashtu kishte vonesa në shqyrtimin e aplikacioneve. Pacientët janë informuar vetëm në ato raste kur kërkesa është aprovuar por nuk janë njoftuar nëse ajo është refuzuar dhe si pasojë pacientet kanë mbetur të pa informuar dhe ju është mohuar e drejta për ankesës apo gjetja e formave të tjera për mbulim të shpenzimeve për trajtim mjekësor”.

Në raportin **“Procesi i rishikimit të teksteve shkollore”**, mesazhi i auditimit është se Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë gjatë procesit të rishikimit të teksteve shkollore, nuk kanë arritur qëllimet e synuara. Procesi i rishikimit ka rezultuar me tekste shkollore të përmirësuara në përqindje të vogla dhe përgjithësisht të natyrës teknike. Mesatarja e ndryshimeve të kryera për tekstet e tri shtëpive botuese ishte 8%. Objektiva lidhur me lehtësimin e çantës shkollore nuk është prekur fare. Ndërkohë që vendimi për të botuar të gjithë tirazhin e teksteve shkollore nga klasa 1-9, përfshirë ato që nuk i janë nënshtruar rishikimit, ka krijuar shpenzime të mëdha e jo kursime siç ishte synuar fillimisht”.

Në Raportin **“Fondi Zhvillimor”**, mesazhi i auditimit është se “Qeveria e Kosovës dhe Bordi menaxhues i fondit nuk kanë instaluar një sistem funksional për menaxhimin e këtij Fondi. Mangësitë kryesore janë identifikuar në pajtueshmërinë me legjislacionin vendor dhe vonesat në aprovimin e projekteve, Andaj realizimi i projekteve nga komunat është në nivel të ulët, dhe deri në shtator të vitit 2016 vetëm 2 nga 21 projekte janë realizuar dhe kanë arritur qëllimin e synuar me këtë fond”.

Në Raportin **“Menaxhimi dhe monitorimi i investimeve kapitale në ndërmarrjet publike”** mesazhi i auditimit është se “Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk ka siguruar që mekanizmat e vendosura të janë plotësisht efektive për të siguruar mbarëvajtjen e proceseve që nga planifikimi për financimin e projekteve kapitale, realizimin dhe monitorim e tyre. Ndërmarrjet Publike³ si

³ “Infra Kos”, Kompania Regjionale e Ujit “Radoniqi”, Kompania Regjionale e Ujit “Drini i Bardhë”, Kompania Regjionale e Mbeturinave “Eko Regjioni” dhe Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastërtia”

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

përfituese të fondeve nga Qeveria e Kosovës kanë arritur të menaxhojnë investimet kapitale në nivel të kënaqshëm drejt realizimit të qëllimit për çka janë dhënë mjetet. Megjithatë edhe përkundër kësaj ende ekzistojnë mangësi në funksionalizimin e plotë të projekteve dhe mos përmbushje të plotë të kriterëve të përcaktuara”.

Në Raportin **“Menaxhimi i procesit të prokurimit për mirëmbajtjen e rrugëve”**, mesazhi i auditimit është se “Ministria e Infrastrukturës dhe Komuna e Prishtinës gjatë procesit të prokurimit për Mirëmbajtje të rrugëve kanë arritur pjesërisht rezultatet e synuara. Procesi i prokurimit ka rezultuar me vonesa, aneks kontrata, konkurrencë të ulët si dhe në disa raste ka rezultuar me mos arritje të vlerës për para gjë që ka shkaktuar edhe kosto shtesë. Specifikacionet teknike të përpiluara nga këto institucione nuk janë bërë siç duhet duke mos përcaktuar gjatësinë dhe gjerësinë e rrugëve dhe për pasoj nuk kanë mundur të përcaktohen shpenzimet e plota për mirëmbajtje të rrugëve për kilometër”.

Në Raportin **“Planifikimi për kontrata të ndërtimit”**, mesazhi i auditimit është se “Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve kanë hasur në vështirësi në menaxhimin efektiv të planifikimit të kontratave të ndërtimit. Përcaktimi i nevojave të përdoruesit dhe ekzaminimi i kushteve fizike të lokacioneve është përcjell me probleme, po ashtu vështirësitë janë vërejtur lidhur me financimin e projekteve dhe sigurimin nëse specifikimet teknike përputhen plotësisht me realitetin. E gjithë kjo ka rezultuar që projektet e ndërtimit të kenë tejkalim të kostove dhe vonesa në realizim”.

Në Raportin **“Procedurat dhe kontrollet në sistemin për menaxhimin e performancës komunale”**, mesazhi i auditimit është se “Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal nuk kishte krijuar të gjitha parakushtet e nevojshme për funksionimin e Sistemit për Menaxhimin e Performancës Komunale. Komunat kishin vështirësi në aplikimin e procedurave dhe kontrolleve të parapara me sistem. Procedura e mbledhjes së të dhënave nuk ishin të duhura, probleme kishte edhe raportimi, verifikimi i të dhënave dhe sigurimi i qasjes në të dhëna nga njësitë komunale. Si rrjedhojë e kësaj disa prej të dhënave të raportuara nuk ishin të mbështetura në dokumente të fushave përkatëse, apo siç ishte përcaktuar nga metodologjia”.

Në Raportin **“Efikasiteti i menaxhimit të lëndëve civile në gjykatat themelore”**, mesazhi i auditimit është se “Gjykatat Themelore të Prishtinës, Pejës dhe Gjilanit nuk janë efikase në menaxhimin e lëndëve civile, po ashtu ky proces është karakterizuar me parregullsi të shumta në të gjitha fazat e tij. Gjykatat vazhdojnë të ballafaqohen me numër të konsiderueshëm të lëndëve të vjetra që vazhdojnë të mbesin ende të pazgjidhura. Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk është treguar efikas për të monitoruar në mënyrë të duhur progresin e arritur nëpër Gjykata. Mekanizmat e përgjithësuar nga Këshilli vështirësojnë monitorimin e progresit të arritur në Gjykata dhe nuk janë mjete të duhura për të adresuar parregullsitë që hasin gjatë menaxhimit me lëndë gjyqësore”.

Në Raportin **“Marrëveshjet për shërbimet e veçanta dhe kontratat e punës për detyra specifike”**, mesazhi i auditimit është se “Ministria e Administratës Publike nuk kishte hartuar legjislacionin sekondar/procedurat për këtë lloj angazhimi përmes të cilit do të përcaktoheshin procedurat e angazhimit, dhe do të siguronin se menaxhimi i tyre është bërë në pajtim me parimin e

transparencës, barazisë dhe konkurrencës. Në anën tjetër Ministrinë⁴ dhe Komunitat⁵ e audituara kishin angazhuar punonjës me këto marrëveshje/kontrata pa ndonjë planifikim të mirëfilltë dhe monitorim formal lidhur me performancën e tyre. Raportimi nuk ishte i plotë dhe i saktë, po ashtu edhe kostot financiare janë rritur krahasuar me vitin paraprak.

Në Raportin **“Efikasiteti dhe efektiviteti në implementimin e sistemit informativ unik të integruar shëndetësor”**, mesazhi i auditimit është se “Ministria e Shëndetësisë nuk ka qenë efikase dhe efektive në implementimin e Sistemit Informativ Shëndetësorë duke mos e funksionalizuar plotësisht. Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur ta realizojë shtrirjen dhe implementimin e tij në 30% të territorit të vendit. Kjo ka shkaktuar një numër barrierash tjera të rëndësishme për qytetarët e vendit, e njëra ndër to me rëndësi të veçantë është zhvillimi dhe implementimi i Sistemit Informativ të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore”.

Në Raportin **“Zbatimi i kontratës për sistemin e prokurimit elektronik”**, mesazhi i auditimit është se “Prej 13 (trembëdhjetë) rekomandimeve, 2 (dy) rekomandime janë adresuar dhe është vërejtur progres fillestar, për 9 (nëntë) rekomandime është identifikuar nevoja për adresim por nuk janë ndërmarrë hapa konkret, përderisa për 2 (dy) rekomandime nuk është ndërmarr asnjë hap për adresimin e tyre dhe nuk janë identifikuar nevojat për adresimin e tyre”.

Meqë arritja dhe ruajtja e cilësisë së lartë gjatë procesit të auditimit mbetet një ndër prioritet tona kryesore, për këtë qëllim ne kemi kërkuar mbështetjen e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, në rritjen cilësisë së auditimeve të performancës. Aktualisht janë tri auditime të performancës të cilat janë nën mentorimin e tyre.

⁴ Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Infrastrukturës.

⁵ Ferizaj, Pejë, Gjiilan, Prizren, Suharekë dhe Prishtinë.

2.4 Menaxhimi Financiar, Pasuritë dhe Shërbimet Mbështetëse

Burimi i financimit të aktiviteteve të ZKA-së është Buxheti i Kosovës. Përveç këtij burimi, ZKA, në zbatim të misionit të vet pranon edhe donacione dhe grante të ndryshme si mbështetje e aktiviteteve dhe funksioneve të saj.

2.4.1 Burimet financiare

Me Ligjin e Buxhetit Nr. 05/L-125 për vitin 2017, buxheti fillestar i aprovuar ishte 2,397,794€. Ndërsa pas rishikimit buxhetor, buxheti final kishte vlerën 2,381,810€. Në fund të vitit buxheti i shpenzuar ishte në shumën 2,273.035€. Ecuria e ndryshimeve buxhetore dhe realizimi i shpenzimeve për të gjitha kategoritë ekonomike është si në vijim:

Paga dhe mëditje: Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2017 ishte 1,767,505 €. Në fund të vitit buxheti i realizuar ishte 1,757,170€, ose shprehur në përqindje në shkallën 99.4%.

Mallra dhe shërbime: Me buxhetin fillestar buxheti i aprovuar për këtë kategori ishte 551,289€. Me rishikim të buxhetit është ndarë një shumë shtesë në vlerë prej 49,000€ me qëllim të mbulimit të qirasë për objektin që e shfrytëzon ZKA. Buxheti përfundimtar në këtë kategori ishte 567,305.69€, kurse u shpenzua në nivel prej 83.9%.

Ndryshimet gjatë vitit ishin si në vijim:

- Me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 10/19 të datës 15.12.2017, ndarja buxhetore në këtë kategori ekonomike u shkurtua për 24,855€ në emër të kursimeve; dhe
- Me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 01/21 të datës 22.12.2017, ndarja buxhetore në këtë kategori ekonomike u shkurtua për 8,128€ në emër të reduktimeve.

Totali i shkurtimeve buxhetore në emër të kursimeve dhe reduktimeve është në shumën 32,983€.

Në fakt në kategorinë ekonomike “Mallra dhe shërbime”, ZKA kishte kursime në shumë prej 24,855€, kurse shkurtime me vendim të Qeverisë në këtë kategori ishin në shumë prej 8,128€ si dhe në kategorinë ekonomike “Investime kapitale” në shumë prej 30,000€. Shkurtime ndodhën pasi që në tremujorin e fundit të vitit 2017 kishte kufizime të theksuara nga MF për menaxhimin e buxhetit. Alokimi i buxhetit për tremujorin e fundit u bë me vonesë të konsiderueshme dhe vetëm pas rishikimit të buxhetit me ligjin përkatës. Kjo ndikoi që disa objektiva dhe nevoja të planifikuara të mos realizohen në pamundësi kohore për zotimin e mjeteve dhe zhvillimin e procedurave përkatëse për përmbushjen e nevojave si dhe për kryerjen e pagesave ndaj kreditorëve.

Në grantet e përcaktuara të donatorëve përfshihet shuma e alokuar prej 164,930€ nga Qeveria e Kosovës për zbatimin e projektit “Fuqizimi i kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditim të prokurimit”, shumë e cila do të rimbursohet nga Banka Botërore sipas marrëveshjes. Në këtë shumë përfshihen edhe mjetet për projektin “Mbështetje të AP-së dhe ZKA-së në përmirësimin e efikasitetit institucional” – të financuar nga Qeveria Zvicerane – Helvetas Swis, Intercooperation/ DEMOS në shumën prej 45,700€ të ndara në vitin 2017, si dhe 10,540€ të bartura nga viti 2016. Shuma e përgjithshme nga grantet e përcaktuara të donatorëve për këtë kategori

ekonomike ishte 221,170€, kurse shpenzimet ishin në shumën prej 53,751€. Meqenëse gjatë vitit 2017 nuk janë kontraktuar ekspertët për zbatimin e projektit “Fuqizimi i kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditim të prokurimit”, donacioni i Bankës Botërore nuk ka filluar të shpenzohet. Ky projekt do të zgjatë deri në shtator të vitit 2019. Kurse donacioni nga “Demos” është realizuar sipas planifikimit.

Shpenzimet komunale: Me buxhetin fillestar buxheti i aprovuar për këtë kategori ishte 34,000€. Buxheti i realizuar në fund të vitit për këtë kategori ekonomike ishte në shumën 27,718€, ose shprehur në përqindje 81.53%.

Investime kapitale: Buxheti fillestar për këtë kategori ishte aprovuar në shumën prej 45,000€. Ndryshimet gjatë vitit janë si në vijim:

- Me vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr. 08/15 të datës 02.08.2017, është bërë reduktimi i fondeve të alokuara në shumën prej 30,000€ për dy projekte kapitale (softuer për mbështetje në auditim dhe serveri për përforcim të infrastrukturës së IT-së);
- Me vendimin e Qeverisë Nr. 10/19 të datës 15.12.2017, ndarja buxhetore në këtë kategori ekonomike u shkurtua për 2,000€ në emër të kursimeve; dhe

Pas rishikimit të buxhetit, shuma në këtë kategori ekonomike ishte 13,000€, kurse niveli i realizimit ishte 12,260€, ose shprehur në përqindje 94.3%.

Në total buxheti final i ndarë për ZKA-në me Ligjin e Buxhetit është realizuar në nivel prej 95.4%.


Struktura e buxhetit bazuar në buxhetin fillestar, ndryshimet gjatë vitit dhe shpenzimet e realizuara, janë paraqitur në tabelën në vijim:

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Tabela 4: Struktura e buxhetit sipas Ligjit për Buxhetin dhe niveli i realizimit në 000€

Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	%
2017				
Buxheti i përgjithshëm	2,398	2,382	2,273	95.4%
Pagat dhe mëditjet	1,768	1,768	1,757	99.4%
Mallrat dhe shërbimet	551	567	467	83.9%
Shërbimet komunale	34	34	28	81.5%
Investimet kapitale	45	13	12	94.3%
2016				
Buxheti i përgjithshëm	2,309	2,264	2,235	98.3%
Pagat dhe mëditjet	1,674	1,704	1,690	99.2%
Mallrat dhe shërbimet	551	521	507	97.3%
Shërbimet komunale	34	26	25	96.0%
Investimet kapitale	50	13	13	100.0%
2015				
Buxheti i përgjithshëm	2,213	2,234	2,203	98.16%
Pagat dhe mëditjet	1,574	1,613	1,613	100.0%
Mallrat dhe shërbimet	605	594	564	94.9%
Shërbimet komunale	34	27	26	97.2%
Investimet kapitale				0.0%


Grafiku nr. 1: Shpenzimet nëpër kategori ekonomike



Nga grafiku i mësipërm vërejmë se kategoria e pagave dhe mëditjeve tërheqë shumën më të madhe të buxhetit të ZKA-së me 77% të shumës së përgjithshme, pastaj pasohet nga mallra dhe shërbimet me 21%, ndërsa shpenzimet komunale dhe kapitale janë në shkallën 1% respektivisht.

Grafiku nr. 2: Shpenzimet për mallra dhe shërbime

- Shpenzimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit
- Shërbimet e arsimit dhe trajnimit
- Shërbime intelektuale&Këshillëdhënëse (auditimi i MAPL)
- Shërbimet kontraktuale
- Mirëmbajtja dhe sigurimi (ndertesat, TI, veturat)
- Naftë (vetura, nxemje, gjenerator)
- Pajisje dhe furnizime (zyrë, pastrim, tjera)
- Qiraja (objekti, pajisje, etj)
- Të tjera (publikime, shtypje, shërbime të postës-PTK/Vala, internet...)




RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Nga grafiku nr. 2 vërejmë që sikurse edhe viteve të kaluara, shpenzimet e qirasë mbeten kostoja më e lartë gjatë vitit 2017 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, shprehur në përqindje 32%. ZKA vazhdon të ushtroj aktivitetin e saj në objektet private, përkundër zotimeve të Qeverisë për të gjetur një zgjidhje për vendosjen e ZKA-së në një objekt publik.

Shpenzimet tjera:

- 24 % e shpenzimeve kanë të bëjë me pagesat për udhëtimet brenda dhe jashtë vendit. Këto shpenzime kanë ndodhur si rezultat i rritjes së numrit të auditimeve në komunat të cilat janë 50km larg Prishtinës. Për më tepër, këtu përfshihen edhe angazhimi i shtuar në lobimin për anëtarësimin e ZKA-së nëpër Organizata Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, përmes pjesëmarrjes në punëtori dhe konferenca, seminare ndërkombëtare jashtë vendit etj.;
- 15% e shpenzimeve ka të bëjë me pagesat për blerje të pajisjeve të TI-së dhe furnizime tjera për zyre.

Grafiku nr. 3: Shpenzimet nëpër kategori, krahasuar me buxhetin e shpenzuar⁶



Nga grafiku nr. 3 mund të vërehet se shpenzimet e realizuara në tre vitet e fundit janë në trendin e njëjtë për të gjitha kategoritë ekonomike.

⁶ Në këtë grafik nuk përfshihen mjetet e ndara nga grantet e përcaktuara të donatorëve të vitit 2017, pasi që ato janë shpalosur ndaras në këtë raport.

2.5 Burimet njerëzore dhe trajnimet

Burimet njerëzore janë shtylla kryesore e ZKA-së, pasi që përmes tyre realizohen objektivat strategjike të institucionit. Me qëllim të rritjes së cilësisë në punë, dhe të kryerjes së më shumë auditimeve, kemi krijuar një qasje të re të menaxhimit të burimeve njerëzore. Fokusi ynë është drejtuar në zhvillim profesional të kapaciteteve njerëzore, ku përmes ngritjes së vazhdueshme profesionale të punonjësve dhe ndërtimit të karrierës në ZKA, synojmë të forcojmë kompetencën në punën tonë profesionale.

Analizë e strukturës së burimeve njerëzore

Kufiri i lejuar i punonjësve për vitin 2017, sipas Ligjit të Buxhetit, është 160 punonjës. Në raport me vitin 2016, nuk ka pasur ndonjë rritje të theksuar në numrin e përgjithshëm të punonjësve. Në fund të vitit 2017, ZKA ka pasur të angazhuar gjithsejtë 159 punonjës, përfshirë Auditorin e Përgjithshëm, nivelin e lartë drejtues, auditorët dhe personelin tjetër profesional dhe administrativ.

Statistikat e personelit përgjatë viteve janë dhënë në tabelën në vijim:

Tabela 5: Personeli nëpër vite

Viti	Kufiri i lejuar personelit	Numri i personelit nga komunitetet	Përqindja e femrave	Mosha mesatare	Numri i udhëheqësve të ekipit	% Lëvizja e personelit	Përvoja në zyrë më e gjatë se dy vite
2015	146	5	49.3%	37.9	42	1.36	138
2016	146	5	49.7%	39.0	33	0.00	143
2017	160	4	50.3%	39.6	41	2.52	146

Numri i punonjësve nga komunitetet tjera ka pasur rënie si rrjedhojë e dorëheqjes nga puna.

Statistika gjinore sipas shënimeve nga tabela e mësipërme, është e ndarë në 49.7% meshkuj dhe 50.3% femërore. Përveç kësaj, edhe numri i femrave në pozita udhëheqëse në të gjitha nivelet është i konsiderueshëm.

Numri i udhëheqësve të ekipeve të auditimit është më i lartë se sa në vitin e kaluar për shkak të mbulimit të më shumë projekteve audituese që mbulohej nga stafi brenda ZKA-së.

Struktura e moshës së punonjësve të ZKA-së dominohet nga mosha e re dhe ajo e mesme, derisa mosha e shtyrë është në kuotat e 14.5% Ky është një tregues që ZKA disponon kuadër me përvojë, kompetencë dhe me potencial për të ardhmen.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Tabela 6: Struktura sipas moshës

Kategoritë e punonjësve	22 - 30	31 - 40	41 - 50	51 - 60	61 - 65
Niveli drejtues	1	13	14	3	0
Auditorët	25	51	19	12	2
Punonjësit mbështetës	0	96	7	6	0
Total	26	30	40	21	2

Mbi 91.8% të punonjësve kanë më shumë se dy vite përvojë me ZKA, gjë që dëshmon se punonjësit janë të pajisur me njohuritë dhe përvojat e nevojshme për mjedisin e punës së auditimit.

Tabela më poshtë paraqet një pasqyrë të pozitive udhëheqëse në ZKA

Këtu përfshihen nivelet drejtuese, niveli i mesëm drejtues, pozitat e udhëheqësve të ekipeve të auditimit, si dhe udhëheqësit e njësive profesionale – administrative.

Tabela 7: Pozitat drejtuese sipas gjinisë në funksionet udhëheqëse

Viti	Numri i drejtorëve (femra)	Përqindja %	Numri i drejtorëve (meshkuj)	Përqindja %	Numri i përgjithshëm i femrave në pozita udhëheqëse	Përqindja %	Numri i përgjithshëm i meshkujve në pozita udhëheqëse	Përqindja %
2015	7	41.2	10	58.8	28	43.1	37	56.9
2016	7	36.8	12	63.2	25	41.7	35	58.3
2017	7	29.0	17	71.0	33	45.8	39	54.2

Në fund të vitit 2017, ZKA kishte 159 punonjës apo 83% që përfshijnë nivelin e lartë drejtues dhe auditorët dhe 17% shërbyes civil dhe punonjës mbështetës.

Tabela 8: Kategoritë e personelit

Kategoria	2017		2016		2015	
	Shifra aktuale	Pozitat e lejuara	Shifra aktuale	Pozitat e lejuara	Shifra aktuale	Pozitat e lejuara
Niveli i lartë drejtues & Auditorët	132		128		123	
Shërbyesit civil/ punonjësit mbështetës	27		25		27	
Gjithsej	159	160	153	146	150	146

Procesi i rekrutimit

Gjatë vitit 2017, ZKA ka pranuar gjithsejtë 10 punonjës të rinj. Përveç kësaj, ZKA edhe këtë vit ka angazhuar përkthyes të përkohshëm për përkthimin e raporteve të auditimit. Ky angazhim është realizuar për periudhën prill – qershor 2017.

Përmes përkrahjes së projektit DEMOS – Helvetas Swiss, i cili ka përfunduar në nëntor të vitit 2017, ZKA ka pranuar përkrahje në angazhimin e ekspertëve nga fusha e Auditimit të Performancës dhe Teknologjisë Informative.

2.5.1 Trajnimi profesional i stafit

Zhvillimi i burimeve njerëzore, mbetet prioritet i përhershëm i ZKA-së, pasi që besojmë se me zhvillimin e këtyre kapaciteteve kontribuojmë në cilësi më të mirë të punës, profesionalizëm më të lartë dhe qasje më të organizuar ndaj punës. Fokusi i ZKA-së është në edukimin e vazhdueshëm profesional, ku përmes trajnimeve të brendshme zhvillojmë njohuritë, dhe kompetencën e secilit punonjës në ZKA. Përveç tjerash, ZKA ka vazhduar të investoj edhe në zhvillimin e kapaciteteve drejtuese për nivelin menaxherial të ZKA-së.

Trajnimi i vazhdueshëm profesional

Plani i trajnimeve për vitin 2017 përmban një shtrirje të trajnimeve përgjatë gjithë vitit. Rezultatet e arritura tregojnë një ecuri të suksesshme të procesit të trajnimit, si mënyrë për zhvillimin profesional.

Gjatë vitit 2017, janë mbajtur një sërë trajnimesh e seminaresh të brendshme dhe të jashtme. Janë organizuar mbi 30 seanca trajnimesh me tema të ndryshme, kryesisht nga fusha e auditimit. Në total, 115 punonjës kanë përfituar nga këto trajnime. Përveç këtyre, janë organizuar edhe punëtori, seminare dhe konferenca të ndryshme me qëllim të zhvillimit të proceseve të brendshme të punës.

ZKA ka përftuar edhe nga shkëmbimi i përvojave me institucionet simotra të auditimit, ku veçohet përkrahja e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë (SNAO). Pas nënshkrimit të marrëveshjes në mes të dy institucioneve ZKA dhe SNAO, për bashkëpunimin bilateral, janë mbajtur një numër i punëtorive në fushën e lidershit dhe menaxhimit, ku njohuri kanë përfituar niveli drejtues i ZKA-së.


Një punonjës i ZKA-së ka përfituar përvojë pune tre mujore në Gjykatën Evropiane të Auditimit, e që është realizuar përmes programit të shkëmbimit të përvojave me këtë institucion.

Sistematizimi i pozitave audituese

Gjatë vitit 2017, ZKA, ka bërë sistematizimin dhe kategorizimin e pozitave audituese në përputhje me aktet e brendshme si në vijim: Auditor Senior, Auditor, Auditor Junior dhe Teknik Auditimi.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Grafiku 4 prezanton një pasqyrë të shpërndarjes së këtyre pozitave:



Sindikata e punëtorëve

Sindikata e punëtorëve ka zhvilluar normalisht aktivitetet sindikale. Menaxhmenti i ZKA-së i ka mundësuar kohën dhe kushtet për veprimtari sindikale. Për më tepër sindikata është angazhuar në procese të ndryshme të institucionit, duke përfshirë monitorimin e proceseve të punës, këshillëdhënien në grupe punuese si dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta që për qëllim kishin organizimin e punonjësve apo festimin e ndonjë date të shënuar. Sindikata ka qasje në gjithë sistemin e intranetit të ZKA-së, dhe iu është lënë edhe hapësira e dedikuar për qëllime komunikimi me anëtarë të saj.

2.6 Komunikimi dhe Bashkëpunimi me Palët e Interesit

Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit është një nga objektivat strategjike të ZKA-së, në mënyrë që ata të kuptojnë punën audituese dhe rezultatet e ZKA-së. Kjo bëhet me qëllim që të rriten njohuritë e palëve të interesit, që ata të kuptojnë rolin dhe përgjegjësitë e ZKA-së, si një institucion i pavarur i sektorit publik.

Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin

Gjatë vitit 2017, është thelluar më tej bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, janë mbajtur takime me Presidentin, Kryeministrin dhe udhëheqës të institucioneve tjera të Republikës së Kosovës.

Për më tepër, ZKA ka organizuar një tryezë me përfaqësuesit e lartë të institucioneve publike të vendit, ku janë prezantuar çështjet kryesore të auditimit për vitin 2016 dhe progresi në zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit.

AP ka bashkëpunim të rregullt ndërinstytucional edhe me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit si me:

- Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, duke e informuar në lidhje me rastet indikativë me elemente të veprave penale të cilat hasen gjatë punës audituese;
- Agjencinë Kundër Korrupsionit, duke ofruar informata shitesë dhe sqarime sipas nevojës lidhur me trajtimin e të gjeturave në raportet e auditimit; dhe
- Njësinë për Krime Ekonomike të Policisë së Kosovës, duke i ofruar të dhëna dhe dokumente relevante të siguruar në proceset e auditimit për rastet e caktuara të cilat trajtohen nga hetuesia.

ZKA, në raport me organet e drejtësisë dhe organizmat përkatëse për luftimin e korrupsionit, vepron në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe me legjislacionin kombëtar të fushës penale.

Komunikimi me Mediat, Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile

ZKA ka për synim që të jetë një burim i besueshëm i mendimit të pavarur e objektiv. Meqë, shoqëria është gjithnjë e më e vetëdijshme për mbajtjen e qeverive të përgjegjshme, ZKA ka për qëllim që të stimulojë këtë sjellje, duke arritur direkt tek qytetarët dhe shoqëria civile, dhe duke zhvilluar marrëdhënie të ngushta me ta.

Për këtë arsye, ZKA ka iniciuar themelimin e forumit konsultativ me shoqërinë civile për të koordinuar bashkëpunimin dhe fuqizuar më shumë transparencën dhe llogaridhënien në Kosovë.

ZKA ka vazhduar bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare dhe organizatat donatore, me theks të veçantë; Zyrën e BE-së në Kosovë, USAID-n, Bankën Botërore, GIZ-in, Zyrën Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë dhe OSBE-në, etj.

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË ZKA-së

Bashkëpunimi me ISA partnere

Në zbatim të parimit “Ngritja e kapaciteteve përmes promovimit të të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive”, ZKA-ja mban kontakte dhe ka zhvilluar marrëdhënie të mira me ISA-të në veçanti me ato të vendeve të Evropës dhe më gjerë.

Ky bashkëpunim ofron mundësi për të shkëmbyer pikëpamjet dhe për të ndarë përvojën me vendet tjera në përdorimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik. Bashkëpunimi me ISA-it tjera kryesisht zhvillohet përmes bashkëpunimit bilateral, Rrjetit të ISA-ve të Regjionit, Komitetit të Kontaktit, INTOSAI dhe EUROSAI.

Edhe pse jemi pjesë aktive e këtyre organizatave dhe grupimeve, ZKA-ja në aktivitetet ndërkombëtare përfaqësohet në cilësinë e vëzhguesit, prandaj synimi primar në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar është anëtarësimi me të drejta të barabarta në organizata përkatëse.

Aktivitetet e bëra në vijim janë në zbatim të këtij parimi:

- Gjatë vitit 2017 janë intensifikuar bashkëpunimet bilaterale me ISA-të: të Shqipërisë, Suedisë, Uellsit, Polonisë etj;
- ZKA ka marrë pjesë në aktivitetet e organizatave profesionale të ISA ndërkombëtare e rajonale; Organizatën Evropiane të ISA-ve (EUROSAI), Gjykatën Evropiane të Auditorëve (ECA); Institucionin Suprem të Auditimit Amerikan (GAO), Komitetin e Kontaktit (ISA-të e vendeve të kontaktit të BE-së); Rrjetin e ISA-ve të vendeve kandidate dhe atyre potencialisht kandidate të BE-së, etj;
- Auditori i Përgjithshëm i ka vizituar ISA të Suedisë, Shqipërisë dhe Polonisë ndërsa delegacione të ZKA-së kanë qëndruar edhe ISA të Turqisë dhe ato të rajonit; dhe
- Auditori i Përgjithshëm ka marrë pjesë në takimin e EUROSAI-it me temën “Cilësia e Ajrit” në Gjykatën Evropiane të Auditorëve në Luksemburg, më pas në takimin e 15-të të Grupit të Punës së EUROSAI-të për Auditimet e Mjedisit në Tiranë dhe takimin e Rrjetit të Institucioneve Supreme të Auditimit kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

ZKA ka pritur delegacione të shumta nga ISA rajonale dhe Evropiane, janë mbajtur takime të rregullta me Zyrën e BE-së në Kosovë, Ambasadën e SHBA-ve dhe misionet e ndryshme diplomatike të akredituara në Kosovë.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet akademike, Auditori i Përgjithshëm ka zhvilluar një vizitë pune në Universitetin e Kembrixhit, Mbretëria e Bashkuar si dhe janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Konferenca Vjetore

Në korrik të vitit 2017, është mbajtur konferenca e IX vjetore e ZKA-së me temën “Fuqizimi i llogaridhënies, transparencës dhe integritetit të institucioneve të sektorit publik, përmes zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm”. Kjo konferencë kishte për qëllim që të nxjerren mësimet nga përvojat dhe sfidat nga sezoni i përfunduar i auditimit dhe të bëhen përgatitjet për sezonin e ri auditues. Konferenca është përcjellë nga të gjithë punonjësit e ZKA-së, përfaqësues nga Kuvendi, Qeveria, shoqëria civile, si dhe organizatat donatore.

Për të zhvilluar më tutje bashkëpunimin e qëndrueshëm dhe për të shkëmbyer pikëpamjet lidhur me përvojat, sfidat dhe qasjen në të ardhmen, në konferencë kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kjo konferencë është përkrahur nga ndihma e dhënë e projektit për “Mbështetje të AP-së dhe ZKA në përmirësim të efikasitetit institucional”, të financuar nga Qeveria Zvicerane - Helvetas Swiss Intercooperation/ DEMOS:

3 Fokusi i aktiviteteve të ZKA-së gjatë vitit 2018

Viti 2018 do të jetë një vit shumë i rëndësishëm për ZKA-në, duke qenë se do të fillojë zbatimi i planit të ri strategjik dhe në kuadër të fuqizimit të pavarësisë dhe subjektivitetit ndërkombëtarë të ZKA, planifikohet anëtarësimi në organizata të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare. Gjatë vitit 2018 veprimtaria e ZKA-së do të fokusohet në fushat në vijim:

Fokusi i ZKA-së në aktivitetet e ardhshme do të jetë i orientuar në:

- Rritjen e cilësisë së auditimeve, në përputhje me SNISA-të;
- Rritjen e portofolios së auditimeve të performancës, përfshirë auditimet e TI-së;
- Ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të brendshme institucionale;
- Thellimin e bashkëpunimit me Kuvendin, përkatësisht komisionet parlamentare;
- Komunikimin efektiv dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe mediat;
- Intensifikimin e bashkëpunimit bilateral me ISA-të tjera; dhe
- Angazhimin për anëtarësimin në organizatat rajonale e ndërkombëtare të ISA-ve.

Korniza ligjore, standardet dhe zhvillimi profesional

- Zbatimi i legjislacionit sekondar i hartuar gjatë vitit 2017 në pajtim me Ligjin e ri për ZKA dhe zbatimi i udhëzuesve të brendshëm që burojnë nga legjislacioni i ri;
- Ngritja dhe forcimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të brendshme administrative dhe menaxhimi efikas i ndryshimeve;
- Vazhdimi i edukimit të vazhdueshëm profesional përmes trajnimeve specifike dhe implementimit të skemave profesionale të certifikimit të auditorëve. Përveç trajnimeve të brendshme stafi i ZKA-së do të ndjekë edhe trajnime dhe aktivitete profesionale që organizohen nga institucionet ndërkombëtare të auditimit dhe organizatat partnere, si: EUROSAT, Gjykata Evropiane e Llogarive, Institucioni Suprem i Auditimit të Suedisë. Synohet pjesëmarrja edhe në aktivitetet Institucionit Suprem të Auditimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
- Përcjellja e standardeve të reja me qëllim të ruajtjes së konsistencës dhe zhvillimit të auditimeve në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Rishikimi i doracakëve për auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe të pakove të letrave të punës; dhe
- Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë, përmes kontrolleve të shtuara me rastin e hartimit të planeve dhe programeve të auditimit dhe rishikimit të raporteve individuale të auditimit si dhe Raportit Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Kosovës. Ndërlidhja e cilësisë së punës me vlerësimin e performancës së auditorëve.

Bashkëpunimi dhe kultivimi i marrëdhënieve me palët e interesit në Kosovë dhe organizatat ndërkombëtare

- Do të thellohet më tej bashkëpunimi me Kuvendin me qëllim të rritjes së llogaridhënies në institucionet publike dhe implementimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit:
 - Do të vazhdohet me përgatitjen e përmbledhjeve të raporteve individuale të auditimit për nevoja të komisioneve parlamentare;
 - Do të intensifikohet pjesëmarrja në takimet e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike dhe ofrimi i këshillave dhe sqarimeve të nevojshme për anëtarët e komisioneve të Kuvendit për çështjet e raportuara në raportet e auditimit;
- Do të rritet bashkëpunimi me organizatat donatore;
- Planifikohet fillimi i zbatimit të projektit të binjakëzimit që financohet nga Bashkimi Evropian nga fondet e IPA-s 2017;
- Bashkëpunimi me USAID në kuadër të projektit kundër korrupsionit, përkrahja për integrimin e ZKA-së në mekanizmat ndërkombëtar të ISA-ve;
- Zbatimi i projektit të financuar nga Banka Botërore për fuqizimin e kapaciteteve të ZKA-së për auditime të prokurimit;
- Vazhdimi i bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë (SNAO);
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit me Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve të ndryshme;
- Pjesëmarrja në Kongreset e EUROSAI që është organi më i lartë i Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të Evropës; dhe
- Angazhimi për anëtarësimin e ZKA-së në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA).

4 Llogaridhënia e ZKA-së

Sigurimi i integritetit

Përmes kësaj, ju sigurojë se informacioni në Raportin Vjetor të Performancës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, përfshirë edhe pasqyrat vjetore financiare janë të sakta, të besueshme, dhe objektive.

Deklarata e Transparencës


Përmes kësaj, sigurojë se puna jonë gjatë vitit 2017 është kryer në pajtim me Statutin e Shërbimit Publik dhe Kodin e mirësjelljes së ZKA-së.



Besnik Osmani,

Auditor i Përgjithshëm

Shtojca 1: Struktura organizative 2017/2018



- Menaxhmenti i lartë i Zyrës Kombëtare të Auditimit
- Zyrtarët në funksionet audituese (auditorët)
- Nëpunësit civilë në mbështetjen administrative
- Të punësuarit në Kabinetin e Auditorit të Përgjithshëm

Shtojca 2: Numri dhe lloji i auditimeve

Në fund të sezonit 2016/2017 janë publikuar 109 raporte të auditimit, përfshirë:

Raportin Vjetor të Auditimit për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës për vitin 2016;

92 raporte të auditimit të rregullsisë:

- Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Presidentit dhe Zyrën e Kryeministrit;
- 19 Ministri;
- 38 Komuna;
- 30 Institucione të pavarura; si dhe
- Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës (dy agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Financave⁷).

4 raporte të auditimit të rregullsisë për Ndërmarrjet Publike

- Hekurudhat e Kosovës "Trainkos" sh.a.
- Kompania rajonale e mbeturinave "Pastërtia sh.a." – Ferizaj;
- Kompania për menaxhimin e deponive të Kosovës; dhe
- Ngrohtorja e qytetit Gjakovës.

2 raporte të auditimit të fondeve të donatorëve

- Fondi i Bashkuar për Sektorin e Arsimit; dhe
- Përkrahja për përmirësimin e hartimit (zhvillimit) të politikave në Kosovë.

10 raporte të auditimit të performancës:

- Efikasiteti dhe efektiviteti në implementimin e sistemit informativ unik të integruar shëndetësor;
- Efikasiteti i menaxhimit të lëndëve civile në Gjykatat Themelore;
- Marrëveshjet për shërbimet e veçanta dhe kontratat e punës për detyra specifike;
- Procedurat dhe kontrollet në sistemin për menaxhimin e performancës komunale;
- Planifikimi për kontrata të ndërtimit;
- Menaxhimi dhe monitorimi i investimeve kapitale në ndërmarrjet publike;
- Procesi i rishikimit të teksteve shkollore;

⁷ Doganat e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës janë agjenci ekzekutive të Ministrisë së Financave, PFV-të e tyre integrohen brenda PFV-ve të MF-së. Mirëpo për shkak se 80% e të hyrave të BK-së mblidhen prej tyre ato i kemi audituar ndaras nga PFV të MF-së.

- Zbatimi i kontratës për sistemin e prokurimit elektronik;
- Fondi Zhvillimor; dhe
